L I G J
Nr. 8965, datë 7.11.2002

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR SUBSTANCAT PSIKOTROPE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën e Kombeve të Bashkuara për substancat psikotrope", 1971.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3582, datë 4.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA
MBI SUBSTANCAT PSIKOTROPE, 1971

Përfshirë Aktin Final dhe Rezolucionet e miratuara nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për adaptimin e protokollit mbi substancat psikotrope dhe listat e aneksuara të kësaj Konvente

KOMBET E BASHKUARA
AKTI FINAL I KONFERNCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ADAPTIMIN E PROTOKOLLIT MBI SUBSTANCAT PSIKOTROPE

1. Këshilli Social Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, në lidhje me nenin 62 paragrafi 4 të kapitullit të Kombeve të Bashkuara dhe me parashikimet e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 366 (IV) të 3 dhjetorit 1949, vendosi sipas rezolutës 1474 (XLVIII) për të mbajtur një konferencë të të plotfuqishmëve për adaptimin e një protokolli mbi substancat psikotrope.
2. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për adaptimin e protokollit mbi substancat psikotrope u mbajt në Vjenë nga 11 janar, deri në 21 shkurt 1971.
3.71 Shtetet e mëposhtme të përfaqësuara nga përfaqësuesit në këtë Konferencë:

AlgjeriGana Paraguaj
ArgjentinGreqi Poloni
AustraliGuatemalëPortugali
AustriGuajanaRep. e Koresë
BelgjikëHoli Si Ruanda
BrazilHonduras San Marino
BullgariaHungari Afrika e Jugut
BurmaIndi Spanjë
BjellorusiIranSuedi
KamerunIrak Zvicra

KanadaIrlandëTajlandë
KiliIzraelTogo
KinaItaliTrinidad
TobagoJaponiTunizi
KolumbiLiban Turqi
KongoLiberi Ukrainë
Kosta RikaLuksemburgBashkimi Sovjetik
DanimarkëMeksikaEmiratet e Bashkuara
Rep. DomenikaneMonakoAngli
EkuadorHollandëSHBA
El SalvadoriZelanda e Re Venezuelë
RFGJNikaraguaJugosllavia
FinlandëNorvegjiFrancë
Pakistan GabonPanama

4.Shtetet mëposhtme të përfaqësuar nga një vëzhgues në Konferencë:

Çekosllovaki Rumani
Republika e Vietnamit Uruguaj

5. Agjencia e specializuar e mëposhtme e përfaqësuar në Konferencë:
Organizata Botërore e Shëndetit

6. Bordi Ndërkombëtar i mëposhtëm i përfaqësuar në Konferencë:
Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve

7. Organizata joqeveritare e mëposhtme e përfaqësuar në Konferencë:
Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale ICPO/INTERPOL të ftuar, konform Rezolutës 1474 (XLVIII) të Këshillit Social dhe Ekonomik.

8. Gjenerali A.A.El Hadeka, Drejtor i Zyrës Permanente të Antinarkotikëve të Ligës së Shteteve Arabe, me ftesë të Konferencës, i ftuar gjithashtu për të marrë pjesë me cilësinë e personaliteteve sipas rregullit 39 të rregullave të procedurës.

9. Në lidhje me Rezolutën e Këshillit Ekonomik e Social referuar në paragrafin 1, si dhe sipas rregullave të procedurës së adaptuar nga Konferenca, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e organizatave dhe bordeve të sipërpërmendura morën pjesë në punimet e Konferencës pa të drejtë vote.

10. Konferenca zgjodhi z. E. Nettel (Austri) si President dhe si Zëvendëspresidentë përfaqësuesit e shteteve të mëposhtme:

BrazilGanaIndi
JaponiMeksikoTogo
Turqi Rep. Soc. të B.S. Emiratet e Bashkuara
Britania e Madhe Irlandës së Veriut SHBA

11. Z.V. Winspeare Guicciardi ishte përfaqësuesi i Sekretarisë së Përgjithshme në ditën e hapjes së Konferencës, duke u pasuar më pas me Dr. V. Kusevic.

Sekretari Ekzekutiv i Konferencës ishte Dr. V. Kusevic, Këshilltari Ligjor ishte z. G. Wattles dhe Zëvendësekretari Ekzekutiv ishte z. Ansar Khan.

12. Konferenca dispononte që më parë se të mbahej një projektprotokoll mbi substancat psikotrope përgatitur nga Komisioni për drogat narkotike i Këshillit, si dhe të të tjera dokumente të përgatitura nga Sekretaria e Përgjithshme.

13. Konferenca përcaktoi komitetet e mëposhtme:
Komitetin e Përgjithshëm
Kryetari: Presidenti i Konferencës
Komiteti Teknik
Kryetari: Prof.B.A.Rexed (Suedi)
Komiteti Projektues
Kryetari Z.D.Nikolic (Jugosllavi)
Komiteti mbi Kontrollin e Masave

Kryetari Dr.J.Mabileau (Francë)

Komiteti Kredencial

Kryetari Dr.P.A.Jennings (Irlandë)

14. Komiteti Teknik krijoi Grupin e Punës si më poshtë:

Grupi i Punës i përkohshëm, bazuar mbi nenin 2 (paragrafi 4 dhe 5) (Qëllimi i Kontrollit të Sustancave)

Kyetari: Dr.H.El Hakim (Emiratet e Bashkuara Arabe)

15. Komiteti mbi Kontrollin e Masave krijoi Grupin e Punës si më poshtë:

Grupi i Punës i përkohshëm bazuar mbi nenin 2 (paragrafi 7 dhe 8) (Qëllimi i Kontrollit të Substancave)

Kryetari: z.D.P.Anand (Indi)

Grupi i Punës i përkohshëm bazuar mbi nenin 2 - Masat speciale lidhur me kontollin e preparative

Kryetari:z.D.E.Miller (SHBA)

Grupi i Punës i përkohshëm, bazuar mbi nenin 4 - Limitimi i përdorimit për qëllime mjekësore e shkencore

Kryetari:Dr.A.M.Walshe (Austri)

Grupi i Punës i përkohshëm, bazuar mbi nenin 6 - Masa speciale lidhur me substancat në listën l.

Kryetari: z.J.H.W.Hogwater (Hollandë)

Grupi i Punës i përkohshëm, bazuar mbi nenin 7 - Licencat

Kryetari: z.D.Nikolic (Jugosllavi)

Grupi i Punës i përkohshëm, bazuar mbi nenin 8 - Recetat

Kryetari: Dr.V.V.Olguin (Argjentinë)

Grupi i Punës i përkohshëm bazuar mbi nenin 10 - Procesverbalet

Kryetari z.A.C.Kirca

Grupi i Punës i përkohshëm bazuar mbi nenin 11 dhe 12 - Masat lidhur me tregtinë ndërkombëtare, parandalimin dhe kufizimin në masë të importit dhe eksportit të substancave psikotrope

Kryetari:z.J.P.Bertschinger (Zvicër)

Grupi i Punës i përkohshëm bazuar mbi nenin 14 - Raportet e marra nga Palët Pjesëmarrëse

Kryetari: z.M.K.B. Asante (Gana)

16. Si një rezultat i liberalizimit të saj, sikurse dhe rakordohet në përmbledhjen e procesverbaleve të plenarit, të takimeve të Komitetit të Përgjithshëm dhe të Komitetit të Masave të kontrollit, si dhe raporteve të të gjithë komiteteve, Konferenca adaptoi dhe paraqiti për firmë Konventën mbi Substancat Psikotrope 1971. Në lidhje me këtë Konferencë adaptoi edhe tre rezoluta shtojcë në këtë Akt Final.

U mbajt në Vjenë, më datë 21 shkurt 1971, në një kopje të vetme në gjuhët kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, ku çdo tekst është përkatësisht autentik. Origjinali do të depozitohet në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Me dëshminë e të gjithë të pranishmëve është firmosur Akti Final.

Rezolutat, adaptuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për adaptimin e konventës mbi substancat psikotrope

REZOLUTA 1
APLIKIMI PROVIZOR I KONVENTËS MBI SUBSTANCAT PSIKOTROPE NË PRITJE PËR TË HYRË NË FUQI

Konferenca,

1. fton Shtetet që, në një masë që ata janë në gjendje për ta bërë, të aplikojnë provizorisht masat e kontrollit, parashikuar në Konventën mbi substanca psikotrope në pritje për hyrjen në fuqi të saj për secilin prej tyre;

2. i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të transmetojë këtë Rezolutë te Këshilli Ekonomik e Social, Asambleja e Përgjithshme dhe Organizata Botërore e Shëndetit, duke parë riafirmimin e tyre në lidhje me ftesën bashkëlidhur.

REZOLUTA II
KËRKIME MBI DROGAT AMFETAMINE

Konferenca,

Duke konsideruar që anfitaminat janë në mënyrë të veçantë të prirura për abuzim dhe janë objekte të trafikut të jashtëligjshmëm;

Duke konsideruar që vlera terapeutike e këtyre drogave, sadoqë e pranuar, është e limituar;

1. i kërkon Asamblesë Botërore të Shëndetit të inkurajojë kërkimet për substanca më pak të rrezikshme, në gjendje për të zëvendësuar drogat afitamine dhe të sponsorizojë të tilla kërkime brenda limiteve të përshtatshme;

2. rekomandon që qeveritë me mundësitë e tyre të nevojshme të ndërmarrin të tilla veprime.

REZOLUTA III
NDERIM QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË

Konferenca,

Duke qenë të mbledhur nga rezoluta 1474 (XL-VIII) e Këshillit Ekonomik Social të 24 Marsit 1970;

Të mbledhur në Vjenë nga 11 janari deri më 21 Shkurt 1971, me ftesën e Qeverisë së Republikës së Austrisë;

I shpreh Qeverisë së Republikës Austriake vlerësimet më të thella nga ana saj për lehtësitë dhe mundësitë e krijuara, si dhe gjithashtu falenderimet drejtuar Qeverisë, e cila kontribuoi dukshëm për punën e suksesshme të Konferencës.

Konventa e substancave psikotrope

Palët,

Në interes të shëndetit dhe mirëqenies së njerëzimit;

Duke parë me vëmendje problemet sociale të shëndetit publik që rezultojnë prej abuzimit të disa substancave psikotrope;

Të vendosur për të parandaluar dhe luftuar abuzimin e substancave të tilla dhe trafikut të paligjshëm, i cili i jep ngritje;

Duke konsideruar që masat rigoroze janë të nevojshme për të ndaluar përdorimin e substancave të tilla për qëllimet e ligjëruara;

Duke njohur që përdorimi i substancave psikotrope për qëllime mjeksore dhe shkencore është i pashmangshëm dhe se përshtatshmëria e tyre për të tilla qëllime nuk mund të jetë tërësisht e ndaluar;

Duke besuar që masat efektive kundër abuzimit të substancave të tilla kërkojnë një bashkëpunim dhe veprime universale;

Duke pranuar kompetencën e Kombeve të Bashkuara në fushën e kontrollit të substancave psikotrope dhe duke dashur që organet ndërkombëtare të interesuara të jenë brenda kuadrit të punës së kësaj organizate;

Duke e ditur që një konventë ndërkombëtare është e nevojshme për të kryar këto qëllime;

Ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përdorimi i termave

Me përjashtim të rasteve kur tregohen ose kur konteksti është i kërkuar, termat e mëposhtme në këtë Konventë kanë kuptimet e dhëna si më poshtë:

(a) "Këshilli" do të thotë Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara.

(b) "Komisioni" do të thotë Komisioni mbi Drogat Narkotike i Këshillit.

(c) "Bordi" nënkupton Bordin Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve, të mundësuar në Konventën e vetme mbi drogat narkotike në 1961.

(d) "Sekretaria e Përgjithshme" nënkupton Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

(e) "Substanca psikotrope" nënkupton çfarëdolloj substance, natyrale apo sintetike ose çdo

material natyral në listën I, II, III ose IV.

(f) "Preparati" nënkupton:

(i) çdo solucion ose përzjerje, në çfarëdolloj gjendje fizike, që përmban një ose më tepër substanca psikotrope; ose

(ii) një ose më tepër substanca psikotrope në formë dozash.

(g) "Lista I, lista II, lista III, lista IV" nënkupton listën numërore që i korrespondon substancave psikotrope aneksuar kësaj Konvente, sikurse përcaktohet në lidhje me nenin 2.

(h) "Eksporti" dhe "Importi" nënkuptojnë sipas nocioneve të tyre respektive transferimin fizik të substancave psikotrope nga një shtet në një shtet tjetër.

(i) "Prodhimi" nënkupton të gjitha proceset prej të cilave substancat psikotrope mund të përftohen dhe përfshin gjithashtu edhe përpunimin po aq mirë sa edhe transformimin e substancave psikotrope në të tjera substanca të po këtij lloji. Termi, gjithashtu, përfshin edhe prodhimin e preparateve të tjera si ato që bëhen me recetën e farmacistit.

(j)"Trafik i paligjshëm" nënkupton prodhimin ose trafikimin e substancave psikotrope në kundërshtim me parashikimet e kësaj Konvente.

(k) "Rajoni" nënkupton çdo pjesë të Shtetit, i cili, në pajtim me nenin 28, është i trajtuar si një pjesë e ndarë për qëllimet e kësaj Konvente.

(l) "Ndërtesat" nënkupton ndërtesat ose pjesë të ndërtesave, përfshi këtu edhe tokën që i përket.

Neni 2

Qëllimi i kontrollit të substancave

1. Nëse njëra Palë ose Organizata Botërore e Shëndetit ka informacion lidhur me një substancë, e cila nuk është akoma nën kontrollin ndërkombëtar dhe e cila sipas opinionit të tyre mund të kërkojë plotësimin e kësaj substance tek ndonjë prej listave të kësaj Konvente, duhet të vihet në dijeni Sekretari i Përgjithshëm dhe të mundësohet dhënia e informacionit atij në mbështetje të këtij njoftimi. Procedura të mëtejshme, gjithashtu, do të aplikohen kur Pala ose Organizata Botërore e Shëndetit ka informacion që e justifikon transferimin e një substance prej një Liste në një tjetër midis këtyre listave ose e fshin këtë substancë prej listave.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të trasmetojë njoftime të tilla dhe çdo informacioni të cilin ai do ta konsiderojë të tillë, për Palët, Komisionin dhe kur njoftimi është bërë prej një Pale, tek Organizata Botërore e Shëndetit.

3. Nëse informacioni i transmetuar me të tillë njoftim tregon se substanca është e përshtatshme për t'u përfshirë në listën I ose listën II rrjedhime të paragrafit 4, Palët do të ekzaminojnë, nën dritën e të gjitha informacioneve që disponohen, mundësinë e aplikacioneve provizore për substancat e të gjitha përmasave të kontrollit që aplikohet për substancat në listën I ose II, si të përshtatshme.

4. Nëse Organizata Botërore e Shëndetit shikon se:

(a) substanca ka kapacitet për t'u prodhuar;

(i) një gjendje varësie; dhe

(2) sistem qendror nervor stimulimi ose depresioni, që rezulton në halucinacione ose shqetësime në funksionin motorik ose mendor ose të sjelljes ose perceptimit ose gjendjes; ose

(ii) të njëjtat abuzime dhe të njëjtat efekte dëmtuese si substancat në listat I, II, III ose IV; dhe

(b) ka një evidencë sufficente që substanca po bëhet ose është, ka të ngjarë të jetë bërë abuzuese, kështu, për të ndërtuar një shëndet publik dhe social, si dhe për të garantuar vendosjen e substancës nën kontrollin ndërkombëtar,

Organizata Botërore e Shëndetit do t'i komunikojë Komisionit një vlerësim të substancës, duke përfshirë masën e abuzimit, shkallën e seriozitetit me të cilin ajo ndikon në shëndetin publik dhe problemet sociale dhe shkallën e përdorimit të plotë të substancës në terapinë mjekësore, së bashku me rekomandimet e masave të kontrollit, nëse ka ndonjë të tillë.

5. Komisioni, duke marrë parasysh komunikimin nga Organizata Botërore e Shëndetit, vlerësimet e të cilës do të jenë përcaktuese si në faktorët mjekësorë dhe shkencorë dhe duke mbajtur në mendje faktorët ekonomikë, socialë, ligjorë, administrativë, si dhe të tjerë faktorë që ata mund t'i quajnë përkatës, mund ta shtojnë substancën në listat I, II, III ose IV. Komisioni mund të kërkojë informacione të mëtejshme prej Organizatës Botërore të Shëndetit ose prej burimeve të tjera përkatëse.

6. Nëse një lajmërim sipas paragrafit 1 lidhet me një substancë që tashmë është e vendosur në një prej listave, Organizata Botërore e Shëndetit do të komunikojë tek Komisioni gjetjet e tij të reja, ndonjë vlerësim të ri për substancën që mund ta vendosë atë në lidhje me paragrafin 4 dhe ndonjë rekomandim të ri mbi kontrollin e masave që mund ta shikojë të përshtatshme nën dritën e këtij vlerësimi.

Komisioni, duke marrë në konsideratë komunikimin nga Organizata Botërore e Shëndetit ashtu si në paragrafin 5, dhe duke mbajtur në mendje faktorët referues në këtë paragraf, mund të vendosë të transferojë substancën prej një liste në një tjetër ose ta fshijë atë fare nga listat.

7. Çdo vendim i Komisionit, i marrë në zbatim të këtij neni, do të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm tek Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara tek Palët Shtetërore joanëtare të kësaj Konvente, tek Organizata Botërore e Shëndetit dhe Bordi. Një vendim i tillë do të bëhet plotësisht efektiv me respektimin e çdo Pale 180 ditë pas datës së një komunikimi të tillë, duke përjashtuar ndonjë Palë, e cila brenda kësaj kohe, në lidhje me një vendim për të shtuar një substancë në listë, ka dërguar tek Sekretari i Përgjithshëm një njoftim me shkrim që në pikëpamjen e rrethanave të jashtëzakonshme nuk është në atë pozicion për të ndikuar me anë të kësaj substance në të gjitha parashikimet e Konventës, aplikuar për substancat në këtë listë. Një njoftim i tillë do të vendosë arsyet për këtë veprim të jashtëzakonshëm. Pavarësisht njoftimit të tyre, çdo Palë do të aplikojë si minimum kontrollin e masave të përcaktuara si më poshtë:

(a) Një Palë, me dhënien e një njoftimi të tillë në lidhje me një substancë të mëparshme të pakontrolluar të shtuar në listën I, duhet të marrë në konsideratë, sa më gjatë të jetë e mundur, një kontroll special të masave që numërohen në nenin 7 dhe në lidhje me këtë substancë:

(i) do të kërkojë licenca për prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen siç është përcaktuar në nenin 8 për substancat në listën II;

(ii) do të kërkojë përshkrim mjekësor për të mbështetur ose përjashtuar, si dhe është përcaktuar në nenin 9 për substancat e listës II;

(iii) do të veprojë sipas detyrimeve që lidhen me import-eksportin, të përcaktuara në nenin 12, duke përjashtuar kur është në lidhje me një tjetër Palë që ka dhënë një njoftim të tillë për substancën në fjalë.

(iv) do të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 13 për substancat në listën II në lidhje me parandalimin dhe marrjen e masave kufizuese mbi eksport –importin;

(v) do t'i japë raporte statistikore Bordit, sipas paragrafit 4 (a) të nenit 16; dhe

(vi) do të adaptojë masa sipas nenit 22 për ndalimin e akteve që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e adaptuara vazhduese të detyrimeve të mëparshme.

(b) Një Palë, me dhënien e një njoftimi të tillë në lidhje me një substancë të mëparshme të pakontrolluar të shtuar në listën III, në lidhje me këtë substancë:

(i) do të kërkojë licenca për prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen, siç është përcaktuar në nenin 8;

(ii) do të kërkojë përshkrim mjekësor për mbështetje ose përjashtime, siç është përcaktuar në nenin 9;

(iii) do të veprojë sipas detyrimeve që lidhen me import-eksportin të përcaktuara në nenin 12, duke përjashtuar kur është në lidhje me një tjetër Palë që ka dhënë një njoftim të tillë për substancën në fjalë;

(iv) do të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 13 në lidhje me parandalimin dhe marrjen e masave kufizuese mbi eksport-importin;

(v) do t'i japë raporte statistikore Bordit sipas paragrafit 4 (a), (c) të nenit 16; dhe

(vi) do të bëjë adaptimin e masave sipas nenit 22 për ndalimin e akteve që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e adaptuara vazhduese të detyrimeve të mëparshme.

(c) Një Palë me dhënien e një njoftimi të tillë në lidhje me një substancë të mëparshme të pakontrolluar të shtuar në listën III, në lidhje me këtë substance:

(i) do të kërkojë licenca për prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen siç është përcaktuar në nenin 8;

(ii) do të kërkojë përshkrim mjekësor për mbështetje ose përjashtime si dhe është përcaktuar në nenin 9;

(iii) do të veprojë sipas detyrimeve që lidhen me import-eksportin të përcaktuara në nenin 12, duke përjashtuar kur është në lidhje me një tjetër Palë që ka dhënë një njoftim të tillë për substancën

në fjalë;

(iv) do të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 13 në lidhje me parandalimin dhe marrjen e masave kufizuese mbi eksport-importin;

(v) do t'i japë raporte statistikore bordit sipas paragrafit 4 (a), (c) të nenit 16; dhe

(v) do të bëjë adaptimin e masave sipas nenit 22 për ndalimin e akteve që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e adaptuara vazhduese të detyrimeve të mëparshme.

(d) Një Palë, me dhënien e një njoftimi të tillë në lidhje me një substancë të mëparshme të pakontrolluar të shtuar në listën IV, në lidhje me këtë substancë:

(i) do të kërkojë licenca për prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen siç është përcaktuar në nenin 8;

(ii) do të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara në nenin 13 në lidhje me parandalimin dhe marrjen e masave kufizuese mbi eksport-importin;

(iii) do të bëjë adaptimin e masave sipas nenit 22 për ndalimin e akteve që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e adaptuara vazhduese të detyrimeve të mëparshme.

(e) Një Palë me dhënien e një njoftimi të tillë që ka të bëjë me një substancë të transferuar në një Listë, duke mundësuar kontrolle të rrepta dhe detyrime, do të aplikojë si minimum të gjitha masat e kësaj Konvente aplikuar për Listën prej së cilës ajo ishte transferuar.

8. (a) Vendimet e Komisionit të ndërmarra sipas këtij neni do të jenë tema që do të rishikohen nga Këshilli sipas kërkesës të çdo Pale brenda 180 ditësh nga marrja e njoftimit për vendimin. Kërkesa për rishikim do të dërgohet tek Sekretari i Përgjithshëm, së bashku me të gjitha informacionet përkatëse në të cilat është bazuar kërkesa për rishikim.

(b) Sekretari i Përgjithshëm do të transmetojë kopjet e kërkesës për rishikim, si dhe informacionet përkatëse te Komisioni, tek Organizata Botërore e Shëndetit dhe te të gjitha Palët, duke i ftuar ata për të paraqitur komentet brenda 90 ditësh. Të gjitha komentet e marra do t'i paraqiten për shqyrtim Këshillit.

(c) Këshilli mund të konfirmojë, të ndryshojë ose të kundërshtojë vendimin e Komisionit. Shpallja e vendimit të Këshillit do të transmetohet te të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, te Palët Shtetërore joanëtare të kësaj Konvente, te Komisioni, tek Organizata Botërore e Shëndetit dhe te Bordi.

(d) Gjatë kohëzgjatjes së rishikimit, vendimi origjinal i Komisionit, sipas paragrafit 7, do të qëndrojë në fuqi.

9. Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre për të aplikuar masa të tilla mbikëqyrjeje, që mund të jenë të praktikueshme tek substancat të cilat nuk bien dakord me këtë Konventë, por që mund të përdoren në prodhimin joligjor të substancave psikotrope.

Neni 3

Masa speciale lidhur me kontrollin e preparateve

1. Në kundërshtim, sikurse është mundësuar në paragrafët e mëposhtëm të këtij neni, një preparat i nënshtrohet të njëjtave masa kontrolli, ashtu sikurse edhe substancat të cilat ai përmban dhe nëse ai përmban më tepër se një nga këto substanca të tilla, masat e aplikuara janë nga më të rreptat që lidhen me kontrollin e këtyre substancave.

2. Nëse preparati, duke përmbajtur një substancë psikotrope tjetër nga substancat e përcaktuara në listën I është përgatitur në një mënyrë të tillë që prezantohet si jo i tillë ose i papërfillshëm, rreziku i abuzimit nuk është në një shkallë të lartë dhe substanca nuk është në sasi të prirura për abuzim, ky preparat nuk dëmton shëndetin publik dhe nuk përbën një problem social, ndaj dhe ky preparat mund të jetë përjashtuar nga disa masa kontrolli të mundësuara nga kjo Konventë në lidhje me paragrafin 3.

3. Nëse një Palë vlerëson se preparati i plotëson kushtet e paraqitura në paragrafin precedent, kjo Palë mund të vendosë të përjashtojë preparatin në vendin e tij ose në rajonin e tij prej ndonjë ose prej të gjitha masave të kontrollit, përcaktuar në këtë Konventë, në përjashtim të kërkesave për:

(a) neni 8 (licencat) që vë në zbatim prodhimin;

(b) neni 11 (të dhënat) që zbatojnë përjashtimin e preparativëve;

(c) neni 13 (ndalimi dhe masat rrepta mbi eksport-importin);

(d) neni 15 (inspektimi) që vihen për prodhimin;

(e) neni 16 (të dhënat që duhet t'i bëhen të ditura Palëve), që vihen për përjashtimin e preparativëve;

(f) neni 22 (përgatitjet penale) për shtrirjen e nevojshme për ndalimin e akteve që janë në kundërshtim me ligjet ose rregullat e adaptuara vijuese të detyrimeve të mëparshme.

Pala do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo vendim të tillë, për emrin dhe për përbërjen e preparatit të përjashtuar, si dhe masat e kontrollit prej të cilave është përjashtuar. Sekretari i Përgjithshëm do t'ia transmetojë njoftimin Palëve të tjera, Organizatës Botërore të Shëndetit dhe Bordit.

4. Nëse një Palë ose Organizata Botërore e Shëndetit ka informacion në lidhje me preparatin e përjashtuar si vijon në paragrafin 3, i cili sipas opinionit të tyre mund të kërkojë përfundimin pjesor ose tërësor të përjashtimit, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe të mundësojë atë me informacion në mbështetje të këtij njoftimi. Sekretari i Përgjithshëm do të transmetojë këtë njoftim dhe çdo informacion që ai do ta konsiderojë përkatës për Palët, Komisionin dhe nëse ky njoftim do të jetë bërë nga Organizata Botërore e Shëndetit do t'i komunikohet Komisionit. Organizata Botërore e Shëndetit do t'i komunikojë Komisionit një vlerësim të preparatit që lidhjet me shkaqet e specifikuara në paragrafin 2, së bashku me një rekomandim të masave të kontrollit, nëse ka ndonjë prej të cilave preparati duhet të mos përjashtohet. Komisioni, duke marrë në konsideratë komunikimin nga Organizata Botërore e Shëndetit, vlerësim i së cilës do të përcaktohet si për shkaqet mjekësore, ashtu edhe për ato shkencore studimore dhe duke mbajtur në mend faktorët ekonomikë, socialë, ligjorë, administrativë dhe të tjerë faktorë që mund të quhen përkatës, mund të vendoset të përfundojë përjashtimin e preparatit prej ndonjë ose të gjithë masave të kontrollit. Çdo vendim i Komisionit i marrë në vijim të këtij paragrafi do të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm tek të gjithë Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, Palët Shtetërore jo anëtare të kësaj Konvente, te Organizata Botërore e Shëndetit, si dhe te Bordi. Të gjitha Palët do të marrin masa të përfundojnë përjashtimin prej masave të kontrollit ose masave në fjalë brenda 180 ditësh nga data e komunikimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 4
Të tjera masa speciale lidhur me qëllimin e kontrollit

Në lidhje me substancat psikotrope të tjera nga ato të listës I, Palët mund të lejojnë:

(a) mbajtjen prej udhëtarëve të një sasie të vogël të preparativëve për përdorim personal, ku çdo Palë është e detyruar t'i japë të drejtë kur këto preparate janë siguruar ligjshmërisht;

(b) përdorimin e substancave të këtij lloji në industri për prodhimin e substancave jo psikotrope ose produkteve, që i nënshtrohen aplikimit të masave të kontrollit kërkuar nga Konventa, përderisa substancat psikotrope prodhohen në të tilla kushte që ato në praktikë të mos abuzojnë ose rigjenerojnë;

(c) përdorimin e substancave të tilla, që i nënshtrohen aplikimit të masave të kërkuara të kontrollit nga Konventa për kapjen e kafshëve nga personat specifikisht të autorizuar nga autoritetet kompetente për të përdorur të tilla substanca për këtë qëllim.

Neni 5
Limitimi i përdorimit për qëllimet mjekësore e shkencore

1. Çdo Palë do të limitojë përdorimin e substancave në listën I, sikurse është parashikuar edhe në nenin 7.

2. Çdo Palë, përjashto sa është parashikuar në nenin 4, do të limitojë sipas masave të tilla që i konsideron të përshtatshme në prodhimin, eksportin, importin, shpërndarjen dhe stoqet në tregti, si dhe në përdorimin ose përvetësimin e substancave në listat II, III dhe IV për qëllime mjekësore dhe shkencore.

3. Është e preferueshme që Palët të mos lejojnë përvetësimin e substancave në listën II, III dhe IV, përveçse sipas autoriteteve ligjore.

Neni 6
Administrimi special

Eshtë e pëlqyeshme që, me qëllim vënien në zbatim të masave të kësaj Konvente, çdo Palë të krijojë dhe realizojë një administrim special, i cili mund për nga avantazhet të jetë i njëjtë ose të punojë në bashkëpunim të ngushtë me administratën speciale krijuar si vijim i masave të konventave për kontrollin e drogave narkotike.

Neni 7
Masa speciale lidhur me substancat në listën I

Në lidhje me substancat e listës I, Palët:

(a) do të ndalojnë përdorimin e këtyre substancave, duke përjashtuar rastet e përdorimit shumë të limituar për qëllime shkencore dhe për qëllime mjekësore nga persona të autorizuar në fushën mjekësore e shkencore, të cilët janë direkt nën kontrollin e qeverive të tyre ose specifikisht miratuar prej tyre;

(b) do të kërkojnë që prodhimi, tregtimi, shpërndarja dhe përvetësimi të jenë sipas një licence speciale ose një autorizimi prioritar;

(c) do të mundësojnë për një mbikëqyrje të ngushtë të aktiviteteve dhe akteve të miratuara në paragrafët (a) dhe (b);

(d) do të kufizojnë sasinë e furnizimit për personin e autorizuar në lidhje me sasinë e kërkuar për qëllimin e autorizimit të tij;

(e) do të kërkojnë që personat, duke zbatuar funksionet mjekësore dhe shkencore, të mbajnë të dhëna lidhur me përvetësimin e substancave dhe detajet e përdorimit të tyre, të dhëna të tilla që do të ruhen për të paktën dy vjet pas përdorimit të fundit të shënuar në të; dhe

(f) do të ndalojnë eksportin dhe importin, me përjashtim kur që të dy, eksportuesi dhe importuesi janë autoritete kompetente ose agjensi eksport-importi respektivisht të shtetit ose rajonit, ose persona të tjerë të cilët janë specifikisht të autorizuar nga autoritetet kompetente të shteteve të tyre ose rajonit për këtë qëllim. Kërkesat e paragrafit 1 të nenit 12 për autorizimet e eksportit dhe importit për substancat në listën II do të aplikohen gjithashtu edhe për substancat e listës I.

Neni 8
Licencat

1. Palët do të kërkojnë që prodhimi, tregtimi (përfshi këtu eksport-importin) dhe shpërndarja e substancave të listës II, III dhe IV të jetë e licencuar ose të jetë nën masa kontrolli të tjera të njëjta.

2. Palët:

(a) do të kontrollojnë siç duhet të gjithë personat e autorizuar dhe ndërmarrjet që kryejnë ose janë të ngarkuar në prodhimin, tregtimin (përfshi tregtinë import-eksport) ose shpërndarjen e substancave referuar këto në paragrafin 1;

(b) do të kontrollojnë sipas licencave ose të tjera masa kontrolli të njëjta për ndërmarrjet dhe godinat në të cilat prodhimi, tregtimi apo shpërndarja kryhen;

(c) do të mundësojnë që këto masa të sigurisë të merren me kujdes për të tilla institucione dhe ndërtesa në mënyrë që të parandalojnë vjedhjen ose ndryshimet e destinacionit të preparateve.

3. do të masat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni lidhur me licencat ose me të tjera masa kontrolli të njëjta nuk ka nevojë të aplikohen për t'u zbatuar tek personat e autorizuar, ndërsa zbatojnë funksione terapeutike ose shkencore.

4. Palët do të kërkojnë që të gjithë personat të cilët kanë licenca në lidhje me këtë Konventë ose ndryshe ata që janë të autorizuar, zbatues të paragrafit 1 të këtij neni ose nënparagrafit (b) të nenit 7 do të jenë në mënyrë adeguate të kualifikuar për ekzekutimin efektiv dhe të besueshëm të masave të ligjeve dhe rregulloreve të tilla sikurse janë shpallur në zbatim të kësaj Konvente.

Neni 9
Recetat

1. Palët do të kërkojnë që substancat e listave I, III dhe IV do të shpërndahen për përdorim për individë që zbatojnë vetëm recetat mjekësore, me përjashtim kur individët, ligjshmërisht, shpërndajnë ose administrojnë substanca të tilla në ushtrimet terapeutike ose shkencore të autorizuara.

2. Palët do të marrin masa për të siguruar që recetat për substancat e listës II, III dhe IV të vendosen në lidhje me sondazhet mjekësore praktike dhe t'i nënshtrohen rregullave të tilla, veçanërisht përsa i përket kohës që recetat mund të rimbushen dhe kohëzgjatjes së skadencës që mund të shtyhet, gjë e cila do të mbrojë shëndetin publik dhe mirëqenien.

3. Pavarësisht nga paragrafi 1, një Palë mund, nëse rrethanat që kërkohet dhe në të tilla kushte, duke përfshirë edhe mbajtjen e protokolleve sikurse edhe është përshkruar, farmacistët e autorizuar të licencuar ose të tjerë shpërndarës përcaktohen nga autoritetet përgjegjëse për shëndetin publik në vendin e tyre, pa përshkrim, për përdorim për qëllime mjekësore nga individët në raste të jashtëzakonshme, në sasi të vogla brenda limiteve të përcaktuara nga Palët për substancat e listave III dhe IV.

Neni 10

Paralajmërimet në pako dhe reklamimi

1. Çdo Palë do të kërkojë, duke marrë parasysh rregulloret përkatëse ose rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetit, udhëzues të tillë për përdorim, duke përfshirë paralajmërimet dhe masat e kujdesit që duhet të tregohen në etiketat dhe në ndonjë rast edhe në fletët shoqëruese të mallrave me pakicë të substancave psikotrope kur shihet, sipas opinionit të tij, të jenë të nevojshme për mbrojtjen e përdoruesit.

2. Çdo Palë, duke u mbështetur në masat kushtetuese të vendit ose rajonit të tyre, do të ndalojë reklamat për substanca të tilla në publik.

Neni 11

Procesverbalet

1. Palët do të kërkojnë që në lidhje me substancat në listën I, prodhuesit dhe të gjithë personat e tjerë të autorizuar sipas nenit 7 për të tregtuar dhe shpërndarë këto substanca, të mbajnë procesverbale, duke treguar detajet e sasive të prodhuara, sasitë e mbajtura stok dhe për çdo blerje dhe asgjësim, detajet e sasisë, datën, furnizuesin dhe marrësin, sikurse është përcaktuar nga çdo Palë.

2. Palët do të kërkojnë që në lidhje me substancat në listën II, III, prodhuesit, shpërndarësit, eksportuesit, importuesit të mbajnë procesverbale, sikurse është përcaktuar nga çdo Palë, duke treguar detajet e sasive të prodhuara, sasitë e mbajtura stok dhe për çdo blerje dhe asgjësim, detajet e sasitë, datën, furnizuesin dhe marrësin.

3. Palët do të kërkojnë që në lidhje me substancat në listën II, shitësit me pakicë, institucionet spitalore dhe të kujdesit, si dhe institucionet shkencore, të mbajnë procesverbale, sikurse është përcaktuar për çdo Palë, duke treguar detajet e sasive të prodhuara, sasitë e mbajtura stok dhe për çdo blerje dhe asgjësim, detajet e sasisë, datën, furnizuesin dhe marrësin.

4. Palët duhet të sigurojnë, nëpërmjet metodave të nevojshme dhe duke marrë në konsideratë praktikat profesionale dhe tregtare në shtetet e tyre, që informacioni lidhur me shitjen dhe asgjësimin e substancave të listës III nga shitësit me pakicë, institucionet spitalore dhe të shëndetit, si dhe institucionet shkencore të jetë i përshtatshëm.

5. Palët do të kërkojnë që në lidhje me substancat e listës IV, prodhuesit, eksportuesit dhe importuesit të mbajnë procesverbale, siç mund të jetë përcaktuar nga secila nga Palët, duke treguar sasitë e prodhuara, eksportuara dhe importuara.

6. Palët do të kërkojnë që prodhuesit e preparateve të përjashtuar sipas paragrafit 3 të nenit 3 të mbajnë procesverbale për çdo substancë psikotrope të përdorur në prodhimin e këtij preparati, si dhe për natyrën, sasinë e përgjithshme dhe asgjësimin fillestar të preparateve të përjashtuara të prodhuara diku.

7. Palët do të sigurojnë që procesverbalet dhe informacionet referuar në këtë nen, të cilat janë kërkuar për qëllimet e procesverbaleve sipas nenit 16, do të jenë të ruajtura për të paktën 2 vjet.

Neni 12

Masat lidhur me tregtinë ndërkombëtare

1. (a) Çdo Palë e lejuar për eksportin e importin e substancave e listave I ose II do të kërkojë një autorizim të ndarë të importit ose eksportit, sipas një forme të vendosur nga Komisioni, për t'u zbatuar në çdo eksport ose import të këtij lloji, nëse kjo konsiston në një ose disa substanca.

(b) Një autorizim i tillë do të kërkojë emrin e jopronarit ndërkombëtar ose në mungesë të një emri të tillë, përshkrimin e substancës në listë, sasinë që do të importohet ose eksportohet, formën farmaceutike, emrin dhe adresën e importuesit ose eksportuesit dhe periudhën brenda së cilës eksporti ose importi mund të jetë efektiv. Nëse substanca është eksportuar ose importuar në formën e një preparati, emri i preparatit, nëse ka ndonjë, për t'u pajisur plotësisht. Autorizimi i eksportit do të kërkojë gjithashtu numrin dhe datën e autorizimit të importit, si dhe autoritetet prej të cilave ky është lëshuar.

(c) Përpara se të nxirret një autorizim eksporti, Palët do të kërkojnë një autorizim importi, të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendeve ose rajoneve importuese, si dhe certifikatën, e cila shpjegon se importimi i substancave ose i substancave referuar bashkëngjitur është aprovuar dhe se të tilla autorizime do të bëhen nga persona ose ndërmarrje që aplikojnë për të marrë autorizimin e eksportit.

(d) Një kopje e autorizimit të eksportit do të shoqërojë çdo ngarkesë dhe qeveria që do të lëshojë këtë autorizim eksporti do të dërgojë një kopje te qeveria e vendit ose rajonit që do të importojë këtë.

(e) Qeveria e vendit ose rajonit importues, kur importimi të jetë kryer, do të kthejë autorizimin e eksportit me një certifikatë hyrje për shumën e mallit që aktualisht është importuar, te qeveria e vendit ose rajonit që ka bërë eksportimin.

2. (a) Palët duhet të kërkojnë që për çdo eksport të substancave në listën III, eksportuesit të projektojnë një deklaratë trefishe, sipas një forme të përcaktuar nga Komisioni, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm:

(i) emrin dhe adresën e eksportuesit dhe të importuesit;

(ii) emrin jopronarit ndërkombëtar ose, duke lënë mënjanë këtë emër, destinacionin e substancës në listë;

(iii) sasinë dhe formën farmaceutike në të cilën substanca është e eksportuar dhe, nëse është në formën e preparatit, emrin e preparatit, nëse ka ndonjë; dhe

(iv) datën e shpërndarjes.

(b) Eksportuesit do të mundësojnë autoritetet kompetente të vendeve ose rajoneve të tyre me dy kopje të deklaratës. Ata do të bashkëngjitin kopjen e tretë tek ngarkesa e tyre.

(c) Një Palë, territori i së cilës është eksportues i substancës së listës III, do t'i dërgojë autoriteteve kompetente të vendit importues, me postë, në të cilën kërkohet të regjistrohet patjetër adresa e kthimit dhe e marrësit, sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 90 ditë pas datës së dërgimit, një kopje të deklaratës së marrë nga eksportuesi.

(d) Palët mund të kërkojnë që me marrjen e ngarkesës importuesi të dërgojë një kopje që shoqëron ngarkesën, gjendjen e hyrjes, sasinë e marrë, si dhe datën e marrjes, tek autoritetet kompetente të vendit ose rajonit të tij.

3. Në lidhje me substancat e listës I dhe II, masat shtesë do të aplikohen si më poshtë:

(a) Palët do të ushtrojnë në pikat e hyrjes dhe zonat e lira të njëjtën mbikëqyrje dhe kontroll, si dhe në të tjera pjesë të territorit të tyre, madje ata mund të aplikojnë masa më tepër drastike.

(b) Eksportet e ngarkesave, një kuti postare zyrtare ose në një bankë në llogari të një personi tjetër të ndryshëm me personin që është shënuar në autorizimin e eksportit do të jetë i ndaluar.

(c) Eksportet e ngarkesave të substancave në listën I në depot me marrëveshje janë të ndaluara. Eksportet e ngarkesave të substancave të listës II në depot me marrëveshje janë të ndaluara vetëm nëse qeveria e vendit importues certifikon në autorizimin e importit të paraqitur nga persona ose ndërmarrje aplikuese për autorizimin e eksportit, që ka aprovuar importimin për arsye të vendosjes në magazinat me marrëveshje. Në të tilla raste, autorizimi i eksportit do të certifikojë që ngarkesa është eksportuar për të tilla qëllime. Çdo tërheqje nga magazina me marrëveshje do të kërkojë një leje nga autoritetet që kanë juridiksion mbi këtë magazinë dhe në rast të një destinacioni të huaj do të trajtohet si të jetë një eksport i ri bazuar në këtë Konventë.

(d) Ngarkesat që hyjnë ose dalin nga territori i një Pale të pashoqëruara me një autorizim eksporti do të ndalohen nga autoritetet kompetente.

(e) Një Palë nuk do të lejojë asnjë substancë me destinacion një tjetër vend që të kalojë nëpërmes territorit të saj, nëse ngarkesa është lëvizur ose nuk është lëvizur nga mjeri i transportit në të cilin është mbajtur, në qoftë se nuk është dhënë nga autoritetet kompetente të kësaj Pale një kopje e autorizimit të eksportit për ngarkesën.

(f) Autoritetet kompetente të çdo vendi ose rajoni nëpërmjet të cilit është lejuar ngarkesa e substancave që të kalojë, do të marrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar ndryshimin e destinacionit të ngarkesës në një tjetër destinacion të ndryshëm nga ai që është shënuar në kopjen shoqëruese të autorizimit të eksportit, nëse qeveria e vendit ose e rajonit nëpërmjet të cilit ngarkesa kalon nuk ka autorizuar ndryshimin e destinacionit. Qeveria e vendit ose e rajonit tranzit do të trajtojë çdo ndryshim destinacioni të kërkuar, nëse ky është një eksport nga një vend ose rajon tranziti në një vend ose rajon tjetër të një destinacioni të ri. Nëse ndryshimi i destinacionit është i autorizuar, masa e paragrafit 1 (e) do të apklikohen gjithashtu ndërmjet vendit ose rajonit tranzit dhe vendit ose rajonit, i cili bën eksportin e ngarkesës.

(g) Mosdërgimi i ngarkesës së substancës, ndërsa është në tranzit ose ndërsa është e vendosur në magazinat me marrëveshje, mund t'i nënshtrohet çdo procesi, i cili do të ndryshojë natyrën e substancës në fjalë. Paketimi nuk mund të ndryshohet pa lejen e autoriteteve kompetente.

(h) Masat e nënparagrafëve (e) deri te (g) lidhur me kalimin e substancave nëpërmjet territorit të një Pale nuk aplikohen kur ngarkesa në fjalë është transportuar me avion, i cili nuk ulet në vendin ose rajonin tranzit. Nëse avioni ulet në ndonjë vend ose rajon të tillë, këto masa do të aplikohen po aq sa dhe e kërkojnë rrethanat.

(i) Masat e këtij paragrafi nuk kanë paragjykime mbi masat e marrëveshjeve ndërkombëtare që limitojnë kontrollin, i cili mund të ushtrohet prej secilës Palë mbi substanca të tilla në tranzit.

Neni 13

Ndalimi dhe kufizimi i eksportit dhe importit

1. Njëra Palë mund të njoftojë të gjitha Palët e tjera nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm që është duke ndaluar importin në vendin e vet ose në ndonjë nga rajonet e saj të një ose disa substancave të listave II, III ose IV, të specifikuara në njoftimin e saj. Çdo njoftim i këtij lloji do të specifikojë emrin e substancës që mund të jetë e përcaktuar në listën II, III ose IV, të specifikuara në njoftimin e saj. Çdo njoftim i këtij lloji do të specifikojë emrin e substancës që mund të jetë e përcaktuar në listën II, III ose IV.

2. Nëse një Palë ka qenë e njoftuar për ndalimin sipas paragrafit 1 ajo duhet të marrë të gjitha masat, që asnjë prej substancave të specifikuara në njoftim të mos eksportohet në vendin ose në një nga rajonet e Palës njoftuese.

3. Megjithë masat e paraqitura në paragrafët e mësipërm, një Palë, e cila ka dhënë njoftimin sikurse paraqitet edhe në paragrafin 1, mund të autorizojë sipas një licence speciale në çdo rast importin e sasive të specifikuara të substancave në fjalë ose përbërësve që përmbajnë substanca të tilla. Autoritetet kompetente që lëshojnë dokumentacionet përkatëse e të vendit importues do të dërgojnë dy kopje të licencës speciale të importit, duke paraqitur emrin dhe adresën e importuesit dhe eksportuesit, tek autoritetet kompetente të vendit ose rajonit eksportues, të cilët mund të autorizojnë eksportuesin të bëjë transportimin. Një kopje e licencës speciale të importit, e dhënë nga autoritetet kompetente të vendit ose rajonit eksportues, do të shoqërojë transportin.

Neni 14

Masa speciale në lidhje me transportin e substancave psikotrope në pajisjet e ndihmës së shpejtë të anijeve, avionëve ose formave të tjera të transportit publik të ngarkuar në trafikun ndërkombëtar

1. Transporti ndërkombëtar nga anijet, avionët ose të tjera forma të transportit publik ndërkombëtar, të tilla si trenat hekurudhorë të linjave ndërkombëtare dhe motorët me karroceri, për të tilla sasi të limituara të substancave në listat II, III ose IV që mund të nevojiten gjatë udhëtimit të tyre për qëllimet e ndihmës së shpejtë ose rasteve emergjente nuk do të konsiderohet si eksport, import ose

kalim nga një vend në një tjetër përsa i përket kësaj Konvente.

2. Masat e përshtatshme ruajtëse do të merren nga vendi i regjistrimit për të parandaluar përdorimin vetiak të substancave referuar në paragrafin 1 ose ndryshim të destinacionit të tyre për qëllime të jashtëligjshme. Komisioni, në konsultë me organizata ndërkombëtare të përshtatshme, do të jetë ai që do të rekomandojë të tilla masa mbrojtëse.

3. Transporti ndërkombëtar nga anijet, avionët ose të tjera forma të transportit publik ndërkombëtar, të tilla si trenat hekurudhorë të linjave ndërkombëtare dhe motorët me karroceri, në lidhje me paragrafin 1 do t'i nënshtrohet ligjeve, rregulloreve, lejeve dhe licencave të vendit regjistrues, pa paragjykuar asnjë të drejtë të autoriteteve kompetente lokale për të kryer kontrolle, inspektime dhe për të ushtruar të tjera masa kontrolli në këto transporte. Administrimi i substancave të tilla në raste emergjente nuk do të konsiderohet një dhunim i kërkesave të paragrafit 1 të nenit 9.

Neni 15
Inspektimi

Palët do të kenë një sistem inspektimi të prodhuesve, eksportuesve, importuesve dhe shitësve me shumicë e pakicë të substancave psikotrope dhe të institucioneve mjekësore dhe shkencore të cilët përdorin substanca të tilla. Ata do të krijojnë mundësi për inspektim, i cili do të bëhet po aq frekuentisht sa dhe e konsiderojnë të nevojshme të bëhet, në të gjitha ndërtesat, stoqet dhe procesverbalet.

Neni 16
Raportet që do të mundësohen nga Palët

1. Palët do të mundësojnë Sekretarin e Përgjithshëm me informacionin që Komisioni mund të kërkojë dhe që është i nevojshëm për zbatimin e funksioneve të tij dhe në veçanti Palët do të mund të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm me një raport vjetor lidhur me punën e Konventës në territorin e tyre përfshi këtu informacionet mbi:

(a) ndryshimet e rëndësishme në ligjet dhe rregulloret e tyre lidhur me substancat psikotrope; dhe

(b) dhe zhvillimet sinjifikuese mbi abuzimin dhe trafiqet e paligjshme të substancave psikotrope brenda territoreve të tyre.

2. Palët, gjithashtu, do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm për emrat dhe adresat e autoriteteve qeveritare referuar në nënparagrafin (f) të nenit 7, në nenin 12 dhe në paragrafin 3 të nenit 13. Informacione të tilla do t'i jepen më pas të gjitha Palëve të tjera nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Palët do të dërgojnë sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas ngjarjes, një raport tek Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me ndonjë rast të trafikut të jashtëligjshëm të substancave psikotrope ose konfiskimin e bërë prej çdo trafiku të jashtëligjshëm, të cilin ata do ta konsiderojnë të rëndësishëm për arsye se:

(a) zbulojnë tendenca të reja;

(b) njihen me sasitë e përfshira;

(c) hedhin dritë mbi burimet prej të cilat substancat janë përfituar;

(d) njihen me metodat e përdorura.

Kopjet e raportit do të komunikohen në lidhje me nënparagrafin (b) të nenit 21.

4. Palët do të mundësojnë Bordin me raporte statistikore vjetore sipas formateve të parapërgatitura prej tij:

(a) në lidhje me çdo substancë të listës I dhe II, për sasitë e prodhuara, të eksportuara dhe të importuara prej çdo vendi, ashtu dhe për stoqet e mbajtura nga prodhuesit;

(b) në lidhje me substancat e listave III dhe IV, mbi sasitë e prodhuara, ashtu dhe për sasitë totale të importuara dhe të eksportuara;

(c) në lidhje me çdo substancë të listës II dhe III mbi sasitë e përdorura në prodhimin e një përbërësi të përjashtuar;

(d) dhe në lidhje me çdo substancë të ndryshme nga substanca në listën I, mbi sasitë e përdorura për qëllime industriale sipas nënparagrafit (b) të nenit 4.

Sasitë e prodhuara, të cilat i referohen nënparagrafëve (a) dhe (b) të këtij paragrafi nuk përfshijnë sasitë e përbërësve të prodhuar.

5. Një Palë do ta furnizojë Bordin, sipas kërkesës së tij me informacione suplementare statistikore, që lidhen me periudhat e ardhshme, mbi sasitë e ndonjë substance individuale në listën III dhe IV të eksportuar dhe të importuar prej çdo vendi ose rajoni. Kjo Palë mund të kërkojë që Bordi t'i trajtojë si konfidenciale që të dyja, si kërkesën për informacion, ashtu edhe informacionin e dhënë sipas këtij paragrafi.

6. Palët do të furnizojnë me informacionin referuar paragrafit 1 dhe 4 në një mënyrë të tillë ose në data të tilla ashtu sikurse do t'i kërkojë Komisioni ose Bordi.

Neni 17

Funksionet e Komisionit

1. Komisioni mund të marrë në konsideratë dhe të shqyrtojë të gjitha shkaqet që i përkasin qëllimeve të kësaj Konvente dhe zbatimit të masave të saj, si dhe mund të bëjë rekomandime lidhur me të.

2. Vendimet e Komisionit mundësuar për nenet 2 dhe 3 do të merren nga 2/3 e mazhorancës së anëtarëve të Komisionit.

Neni 18

Raportet e Bordit

1. Bordi do të përgatisë raportet vjetore të punës së tij, që përmbajnë një analizë të informacioneve statistikore në dispozicion të tij, dhe, në rastet e përshtatshme, t'i japë llogari shpjegimeve të dhëna ose të kërkuara nga qeveritë, së bashku me vëzhgimet dhe rekomandimet, të cilat Bordi dëshiron t'i bëjë, gjithmonë nëse ka ndonjë të tillë. Bordi do të përgatisë të tilla raporte shtesë vetëm nëse do t'i konsiderojë të nevojshme. Raportet do t'i paraqiten për shqyrtim Këshillit nëpërmjet Komisionit, i cili më pas do të bëjë komente, nëse e shikon të përshtatshme.

2. Raportet e Bordit do të komunikohen tek Palët dhe do të publikohen në vijueshmëri nga Sekretari i Përgjithshëm. Palët do të lejojnë shpërndarjen e pakufizuar të tyre.

Neni 19

Masat e marra nga Bordi për të siguruar ekzekutimin e kushteve të Konventës

1. (a) Nëse, në bazë të ekzaminimit të tij në lidhje me informacionin e shtruar për shqyrtim nga Qeveritë te Bordi ose për informacionin e komunikuar nga organet e Kombeve të Bashkuara, Bordi ka arsye të besojë që qëllimet e kësaj Konvente po rrezikohen seriozisht si pasojë e dështimit të një vendi ose rajoni në respektimin e kushteve të kësaj Konference, Bordi do të ketë të drejtë të kërkojë shpjegime nga qeveria e vendit ose e rajonit në fjalë. E drejta e Bordit për të kërkuar vëmendjen e Palëve, Këshillit dhe Komisionit për shkaqet e referuar në nënparagrafin (c) më poshtë, do të trajtohet sipas këtij nënparagrafi, si një kërkesë konfidenciale për informacion ose shpjegim nga qeveria.

(b) Pas marrjes së veprimit sipas paragrafit (a), Bordi, nëse e shikon të përshtatshme që është e nevojshme të veprohet kështu, mund të kërkojë për qeverinë në fjalë që të adaptojë masa të tilla rimëkëmbjeje sikur shihen sipas rrethanave, të jenë të nevojshme për ekzekutimin e kushteve të kësaj Konvente.

(c) Nëse Bordi shikon se qeveria në fjalë nuk ka dhënë shpjegime të kënaqshme, kur i është kërkuar të veprojë kështu sipas nënparagrafit (a), ose ka dështuar në adaptimin e masave të rimëkëmbjes, të cilat i janë kërkuar për t'u zbatuar sipas nënparagrafit (b), ai mund të kërkojë vëmendjen e Palëve, të Komisionit dhe të Këshillit lidhur me këtë.

2. Bordi, kur kërkon vëmendjen e Palëve, Këshillit dhe Komisionit për rastet në lidhje me paragrafin 1 (c), nëse është e vlefshme të bëhet e gjithë kjo, mund t'i rekomandojë Palëve që ata të ndalojnë eksportin, importin, ose të dyja bashkë, të disa substancave psikotrope të veçanta, nga një vend ose rajon në një vend ose rajon tjetër në fjalë për një periudhë të caktuar ose derisa Bordi të jetë i kënaqur me situatën në atë vend ose rajon. Shteti në fjalë mund të arsyetojë përpara Këshillit.

3. Bordi do të ketë të drejtë të botojë një raport mbi çdo rast të trajtuar sipas kushteve të këtij neni dhe t'ia komunikojë atë Këshillit, i cili më pas do t'ia kalojë të gjitha Palëve. Nëse Bordi publikon në këtë raport një vendim të marrë sipas këtij neni ose ndonjë informacion lidhur me të, ai gjithashtu do të publikojë në të të gjitha pikëpamjet e qeverisë në fjalë, nëse më vonë do të kërkohet kështu.

4. Në rast se vendimi i Bordit, i cili është i publikuar sipas këtij neni nuk është unanim, do të vendosen edhe pikëpamjet e minorancës.

5. Sipas këtij neni çdo Shtet do të jetë i ftuar për të qenë prezent në takimin e Bordit për çdo pyetje që ata janë të interesuar direkt për të marrë përgjigje.

6. Vendimet e Bordit sipas këtij neni do të merren nga 2/3 e mazhorancës të numrit të përgjithshëm të Bordit.

7. Kushtet e paragrafëve të mësipërm, gjithashtu, do të aplikohen nëse Bordi ka arsye të besojë që qëllimet e kësaj Konvente po rrezikohen seriozisht si rezultat i vendimeve të marra nga një Palë sipas paragrafit 7 të nenit 2.

Neni 20

Masat kundër abuzimit të substancave psikotrope

1. Palët do të marrin të gjitha masat praktike për parandalimin e abuzimit të substancave psikotrope dhe për identifikimin e shpejtë, trajtimin, edukimin, përkujdesin, rehabilitimin dhe riintegrimin social të personave të përfshirë dhe do të koordinojë përpjekjet e tyre për t'i dhënë fund kësaj.

2. Palët do të promovojnë trajnimin e personelit sa më gjatë të jetë e mundur në trajtimin, përkujdesin, rehabilitimin dhe riintegrimin social të abuzuesve të substancave psikotrope.

3. Palët do të asistojnë personat që punojnë në këtë drejtim për të gjitha kërkesat që ata kanë për të kuptuar më mirë problemet e abuzimit të substancave psikotrope dhe parandalimit të tyre dhe gjithashtu do të promovojnë të tilla mirëkuptime nëpërmjet publikut të gjerë, nëse ka rrezik që abuzimi i substancave të tilla do të marrë përmasa të gjera.

Neni 21

Aksioni kundër trafikut të jashtëligjshëm

Për shkak të sistemeve të tyre konstitucionale, ligjore dhe administrative Palët:

(a) do të bëjnë përgatitje në nivel kombëtar për koordinimin e veprimeve parandaluese dhe kufizuese kundër trafikut të jashtëligjshëm; në mbarim të kësaj ata mund të krijojnë një agjenci të përshtatshme përgjegjëse për të tilla koordinime;

(b) do të asistojnë në fushatat e luftës kundër trafikut të jashtëligjshëm të susbtancave psikotrope dhe në veçanti në transmetimin imediat nëpërmjet kanaleve diplomatike ose autoriteteve kompetente të projektuar nga Palët, pikërisht për këtë qëllim, tek Palët e tjera që janë të interesuar direkt, të një kopjeje për çdo raport adresuar Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 16, në lidhje me zbulimin e rasteve të trafikut të jashtëligjshëm ose konfiskimit;

(c) do të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente të të cilave ata janë anëtarë me pikësynimin për të mbajtur një fushatë të koordinuar në luftë kundër trafikut të jashtëligjshëm;

(d) do të sigurojnë që bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet agjencive të përshtatshme të drejtohet në një mënyrë të shpejtë; dhe

(e) do të sigurojnë që, kur dokumentet ligjore janë transmetuar jashtë kufijve shtetërorë për qëllime të procedurave juridike dhe se ky transmetim ndikon në një mënyrë të shpejtë tek organizmat e projektuar nga Palët, kjo kërkesë nuk do të ketë paragjykime në drejtim të Palëve për të kërkuar që dokumentet ligjore të dërgohen tek ato nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 22

Kushtet penale

1.(a) Duke iu nënshtruar limiteve të tyre konstitucionale, çdo Palë do ta trajtojë si një

kundërvajtje të dënueshme, kur bëhet qëllimisht, ndonjë veprim në kundërshtim me ligjin ose rregulloren e adaptuar në vijim të obligimeve të tij sipas kësaj Konvente dhe do të sigurojë që kjo kundërvajtjeje serioze do të jetë përgjegjëse për një dënim adeguat, veçanërisht me burgim ose të tjera penalitete të privimit të lirisë.

(b) Pavarësisht nga nënparagrafët precedentë, kur abuzuesit e substancave psikotrope kanë bërë të tilla kundërvajtje, Palët mund të shikojnë si një alternativë bindje, ose dënimi nënshtrimin e abuzuesve të tillë ndaj masave të trajtimit, edukimit, përkujdesjes, rehabilitimit dhe riintegrimit social, konform paragrafit 1 të nenit 20.

2. Duke iu nënshtruar limiteve konstitucionalë të një Pale, sistemit të saj ligjor dhe ligjit civil përkatës për vendin e saj;

(a) (i) nëse një seri aksionesh që kanë të bëjnë me kundërvajtjet sipas paragrafit 1 janë bërë në vende të ndryshme, secila prej tyre do të trajtohet si një kundërvajtje e veçantë;

(ii) pjesëmarrja në mënyrë të qëllimshme, komploti për të bërë ose në pritje për të bërë të tilla kundërvajtje, si dhe aktet parapërgatitëse dhe operacionet financiare në lidhje me kundërvjajtjet të referuara në këtë nen, do të jenë kundërvajtje të dënueshme, sikurse përshkruhet edhe në paragrafin 1;

(iii) provat e fajësisë nga të huajt për të tilla kundërvajtje do të merren në konsideratë me qëllim për të provuar përsëritjen e veprës penale; dhe

(iv) kundërvajtjet serioze të referuara deri këtu, të kryera si nga shtetasit vendas, ose dhe nga ata të huaj do të ndiqen penalisht nga Pala, në territorin e së cilës është bërë kjo kundërvjajtje, ose nga Pala në territorin e së cilës është gjetur fajtori, nëse ekstradimi nuk është i pranueshëm konform ligjit të Palës së cilës kjo kundravjajtje i është bërë dhe nëse fajtori nuk është akoma i ndjekur penalisht ose nuk i është dhënë gjykimi.

(b) Eshtë e preferueshme që kundërvajtjet e referuara në paragrafin 1 dhe 2 (a): (ii) të jenë të përfshira si ekstradime krimesh në çdo traktat ekstradimi që ka qenë ose më pas konkludohet ndërmjet Palëve, si dhe ndërmjet çdo Pale që nuk bën ekstradimin kushtëzues mbi ekzistencën e një traktati ose mbi reciprocitetet, të njihen si krime ekstradimi; me qëllim që ekstradimi të jetë i garantuar konform ligjit të Palës të cilës i është bërë aplikimi, Pala do të ketë të drejtë të refuzojë të bëjë arrestimin ose të pranojnë ekstradimin në rastet kur autoritetet kompetente e konsiderojnë që kundërvajtja nuk është seriozisht sufiçente.

3. Çdo substancë psikotrope ose një substancë tjetër, ashtu sikurse çdo pajisje e përdorur në ose e parashikuar nga Komisioni për çdo kundërvajtje të referuar në paragrafin 1 dhe 2 do të jetë përgjegjëse për konfiskim.

4. Masat e këtij neni do të jenë të nënshtruar masave të ligjit shtetëror të vetë Palës përkatëse mbi juridiksionin.

5. Asgjë që nuk përmbahet në këtë nen nuk do të ndikojë parimin që kundravajtjet të cilave ky i referohet të jenë të përcaktuara, penalizuara dhe dënuar konform ligjit shtetëror të një Pale.

Neni 23

Aplikimi i masave strikte të kontrollit të tjera nga ato të kërkuara sipas kësaj Konvente

Një Palë mund të adaptojë të tjera masa më strikte ose më të rrepta kontrolli sesa ato të kërkuara nga Konventa, nëse, sipas opinionit të saj, masa të tilla janë të pëlqyeshme ose të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mirëqenies.

Neni 24

Shpenzimet e organeve ndërkombëtare që kërkohen në administrimin e masave të Konventës

Shpenzimet e Komisionit dhe të Bordit në mbajtjen e funksioneve të tyre respektive sipas kësaj Konvente do të krijohen nga Kombet e Bashkuara në mënyra të tilla sikurse do të vendosen nga Asambleja e Përgjithshme. Palët të cilat nuk janë Anëtare të Kombeve të Bashkuara do të kontribuojnë në këto shpenzime me shuma të tilla sikurse do ta shohë të arsyeshme kohë pas kohe Asambleja e Përgjithshme pas konsultimit mbi qeveritë e këtyre Palëve.

Neni 25

Procedurat për pranimin, nënshkrimin, ratifikimin dhe hyrjen

1. Anëtarët e Kombeve të Bashkuara, Shteteve joanëtare të Kombeve të Bashkuara, të cilët janë anëtarë të një agjencie të specializuar të Kombeve të Bashkuara, të Agjencisë së Energjisë Atomike, të Palëve të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë Ndërkombëtare ose dhe të çdo Shteti tjetër të ftuar nga Këshilli mund të bëhen Palë e kësaj Konvente:

(a) duke e nënshkruar atë; ose

(b) duke e ratifikuar atë dhe pas nënshkrimit të saj duke iu nënshtruar ratifikimit; ose

(c) duke e pranuar atë.

2. Konventa do të jetë e hapur për t'u nënshkruar deri në 1 janar 1972, duke e përfshirë dhe këtë datë. Pas kësaj do të jetë e hapur për t'u pranuar.

3. Dokumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 26

Hyrja në fuqi

1. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e 90-të pasi 40 Shtetet e referuara në paragrafin 1 të nenit 25 ta kenë nënshkruar atë pa rezerva të ratifikimit ose të kenë depozituar dokumentet e tyre të ratifikimit ose të pranimit.

2. Për ndonjë tjetër Shtet, që bën nënshkrimin pa rezerva të ratifikimit ose depozitimin e një dokumenti të ratifikimit ose të pranimit pas nënshkrimit të fundit, ose bën depozitimin sikurse edhe referohet në paragrafin e mësipërm, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e 90-të duke ndjekur datën e nënshkrimit të saj ose depozitimit të dokumenteve të tij të ratifikimit ose të pranimit.

Neni 27

Aplikimi territorial

Konventa do të aplikohet tek të gjithë territoret jo metropolitane për lidhjet ndërkombëtare për të cilat çdo Palë është përgjegjëse, me përjashtim kur miratimi i mëparshëm i një territori të tillë është i kërkuar nga Kushtetuta e Palës ose e territorit përkatës, ose i kërkuar nga dogana. Në raste të tilla, Pala do të përpiqet të sigurojë miratimin e nevojshëm të territorit brenda një periudhe kohe mundësisht të shkurtër dhe kur miratimi të jetë marrë, atëherë Pala do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Konventa do të aplikohet në territorin e territoreve të përcaktuara në këto njoftime prej datës së marrjes së tyre nga Sekretari i Përgjithshëm. Në raste të tilla, kur miratimi i territoreve jometropolitane nuk është i kërkuar, Pala përgjegjëse do të deklarojë, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit, territorin ose territoret jometropolitane tek të cilat aplikohet kjo Konventë.

Neni 28

Rajonet për qëllimet e kësaj Konvente

1. Çdo Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që, për qëllimet e kësaj Konvente, territori i saj është i ndarë në dy ose më tepër rajone, ose që këto dy ose më tepër rajone të saj janë konsoliduar në një rajon të vetëm.

2. Dy ose më shumë Palë mund të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm që, si një rezultat i krijimit të një unioni doganor ndërmjet tyre, këto Palë ndërtojnë një rajon për qëllimet e kësaj Konvente.

3. Çdo njoftim sipas paragrafit 1 ose 2 do të ketë efekt në 1 janar të vitit që ndjek vitin në të cilin njoftimi ishte bërë.

Neni 29

Denoncimi

1. Pas skadimit të dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të Konventës, çdo Palë, e cila ka tërhequr miratimin e saj të dhënë në lidhje me nenin 27, mund që, në emër të saj ose të territorit për të

cilin ka përgjegjësi ndërkombëtare, ta denoncojë këtë Konventë me anë të një dokumenti me shkrim të depozituar te Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi, nëse është i marrë nga Sekretari i Përgjithshëm në ditën ose më parë se në ditën e parë të korrikut të çdo viti, do të ketë efekt në ditën e parë të janarit të vitit pasardhës dhe nëse është marrë pas ditës së parë të korrikut do të ketë efekt, ashtu sikurse ka nëse është marrë në ditën ose më parë se në ditën e parë të korrikut në vitin tjetër pasardhës.

3. Konventa nuk do të funksionojë më, nëse si rezultat i denoncimeve të marra në lidhje me paragrafin 1 dhe 2, kushtet për hyrjen në fuqi të saj, sikurse shtrohen në paragrafin 1 të nenit 26, ndalojnë së ekzistuari.

Neni 30
Amendamentet

1. Çdo Palë mund të propozojë një amendament në këtë Konventë. Teksti i një amendamenti të tillë dhe arsyet do të komunikohen te Sekretari i Përgjithshëm, i cili do t'ia komunikojë këto Palëve dhe Këshillit. Këshilli mund të vendosë më pas mbi njërën ose tjetrën:

(a) që Konferenca do të mblidhet në lidhje me nenin 62 të kapitullit të Kombeve të Bashkuara për të konsideruar amendamentin e propozuar; ose

(b) që Palëve t'u kërkohet fillimisht nëse ato e pranojnë amendamentin e propozuar dhe gjithashtu t'i kërkohet t'i paraqesin për shqyrtim Këshillit komentet mbi propozimin.

2. Nëse qarkullimi i një amendamenti të propozuar sipas paragrafit 1 (b) nuk është kundërshtuar nga asnjë Palë brenda 18 muajve pasi është qarkulluar, ai mund të hyjë në fuqi. Sidoqoftë, nëse amendamenti i propozuar është kundërshtuar prej ndonjë Pale, Këshilli mund të vendosë, bazuar në komentet e marra nga Palët, se kur një konferencë mund të mblidhet për të konsideruar një amendament të tillë.

Neni 31
Mosmarrëveshjet

1. Nëse ngrihen mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e Konventës, Palët do të konsultojnë së bashku një mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke negociuar, investiguar, mediatuar, këshilluar, arbitruar, duke iu drejtuar autoriteteve rajonale, duke bërë proces gjyqësor ose duke përdorur mjete të tjera paqeje për zgjidhjen e tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me mënyrat e përshkruara më sipër, do t'i referohet, sipas kërkesës së një ose më shumë Palëve që janë në mosmarrëveshje, Këshillit Ndërkombëtar të Drejtësisë për vendim.

Neni 32
Vërejtjet

1. Nuk do të lejohet asnjë vërejtje tjetër e ndryshme nga ato të bëra në lidhje me paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

2. Çdo Shtet mund që, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit, të bëjë vërejtje në lidhje me masat e mëposhtme të Konventës:

(a) neni 19 paragrafi 1 dhe 2;

(b) neni 27; dhe

(c) neni 31.

3. Një Shtet, i cili dëshiron të bëhet një Palë, por dëshiron të jetë i autorizuar për të bërë vërejtje të tjera nga ato të bëra sipas paragrafit 2 dhe 4, mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm për një veprim të tillë. Nëse në fund të 12 muajve pas datës së komunikimit të Sekretarit të Përgjithshëm për vërejtjen në fjalë, nëse kjo vërejtje është kundërshtuar nga 1/3 e Shteteve që kanë nënshkruar pa rezerva ratifikimin, kanë ratifikuar apo pranuar këtë Konventë përpara përfundimit të kësaj periudhe, do të gjykohet e lejuar, por duke i dhënë të kuptojë Shteteve, të cilat kanë kundërshtuar vërejtjen të mos kenë nevojë të marrin përmes Shtetit që ka bërë vërejtjen ndonjë detyrim ligjor sipas kësaj Konvente, ndaj të cilit ka vërejtje.

4. Një Shtet, në territorin e të cilit janë mbjellë bimë të egra, të cilat përmbajnë substanca psikotrope prej atyre të listës I dhe që janë tradicionalisht të përdorura nga disa grupe të vogla njerëzish në ritet magjike ose fetare, duhet që në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit të bëjë vërejtje në lidhje me këto bimë, sipas masave të nenit 7, me përjashtim të masave që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare.

5. Një Shtet, i cili ka bërë vërejtje, mund në çdo kohë, me anë të një njoftimi me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm, të tërheqë të gjithë ose një pjesë të vërejtjeve të tij.

Neni 33
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm do t'i komunikojë të gjitha Shteteve referuar në paragrafin 1 të nenit 25:

(a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet në lidhje me nenin 25;

(b) datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi sipas nenit 26;

(c) denoncimet sipas nenit 29; dhe

(d) deklarimet dhe njoftimet sipas neneve 27, 28, 30 dhe 32.

Sipas dëshmitarëve, Palët nënshkruese të autorizuara kanë nënshkruar këtë Konventë në emër të qeverive të tyre respektive.

E mbajtur në Vjenë, më 21 shkurt të vitit 1971, në një kopje të vetme në gjuhën kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, secila prej tyre realisht autentike, Konventa do të depozitohet në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila do t'i transmetojë kopje reale të certifikuara të gjithë Anëtarëve të Kombeve të Bashkuara dhe Shteteve të tjera referuar në paragrafin 1 të nenit 25.

TABELAT E RISHIKUARA DUKE PËRFSHIRË NDRYSHIMET E BËRA NGA KOMISIONI MBI DROGAT NARKOTIKE, HYRË NË FUQI NGA 1 KORRIKU 1993*

LISTA E SUBSTANCAVE NË TABELA
LISTA E SUBTANCAVE NË TABELËN I

Nr.	Emërtimi ndërkombëtar	Emërtime të tjera	Emri kimik
1	Brolamfetamine	Dob	(=)-4-bromo-2,5-dimethoxy-a-methylphenethylamine
2	Cathinone		(-)-(S)-2-aminopropiophenone
3		Det	3-(2-(diethylamino)ethyl)indole
4		Dma	(=)-2,5-dimethoxy-a-methylphenethylamine
5		Dmhp	3-(1,2-dimethylheptyl)-7,8,9,10-cetrahydro-6.6,9 trimethyl-6H-dibenzolëb,a] pyran-1-ol
6		Dmt	3-ë2-(dimethylamino)ethyl]indole
7		Doet	(=)-4-ethyl-2,5-dimethoxy-a-phenethylamine
8	N-ethyl tenamfetamine	Mde,N-ethyl Mda	(=Nethyl-a-methyl-3.4-(methylenedioxy)phenethylamine
9	Eticyclidine	Pce	N-ethyl-l;phenylcyclohexylamine
10	N-hydroxyl-tenamfet-amine	N-oh Mda,n-hydroxymda	(=)-N-ëa-methyl-3-4-(methylenedioxy)chenethyl-hydroxylamine
11	(-)-Lysergide	Lsd, Lsd-25	9.10-didehydro-V,-V-diedryl-5-methylergoline-3-3-carboxamide
12		Mdma	(=)-V,a-dimethyl-3,4,(methylenedioxy), chenethylamine
13		Mescaline	3,4,5-trimethoxyphenethylamine
14	4-Methylamino-rex		(=)-cis-2-amino-4-methyl 5-phenyl - 2-oxazoline(=)-cis-4,5-dihydro-4-methyl -5-phenyl-2-oxazolamine
15		Mmda	2-methoxy-a-methyl-4,5-(methylenedioxy)phenethylamine
16		Parahexyl	3-hexyl-7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9 trimethyl-6H -dibenzo ëb,d] pyran -l-ol

17		Pma	p-methoxy-a-amethylphen-ethylamine
18		Psilocine, psilotsin	3-[2-(dimethylamino)ethyl) Indol-4-ol
19	Psilocybine		3-(2-dimehthylamino)ethyl)indol-4-yl dihydrogen phosphate
20	Rolicylidine	Php,Pcpy	1-(1-phenylcyclohexyl)pyrroiidine
21		Stp,Dom	2,5-dimethoxy-a,4-dimethyl-phenethylamine
22	Tenamfetamine	Mda	a-methyl-3,4-(methyllenedioxy) phenethylamine
23	Tenocyclidine	Tcp	1-)1-(2-thienyl)cyclohexyl)piperidine
24			Tetrahydrocannabinol, the following isomers and their stereochemical variants 7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl 3-pentyl - 6H-dibenzol [b,d] pyran-l-ol (9 R.10aR)-8,9,10,10a-tetrahydro 6,6,9-trimethyl-3-pentyl - 6H-dibenzo [b,d] pyran-1-ol (6aR.9R,10aR)-6a.9,10,10a-tetrahydro 6,6,9-trimethyl -3-pentyl – 6 H- dibenzo[b,d] pyran -1-ol (6aR.10aR)-6a7,10,1)a-tetrahydro- 6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6H-dibenzo[b.d)] pyran -1-ol 6a,7,8,9-tetrahydro-6,6,9-trimethyl -3-pentyl-6H-dibenxol (b,d) pyran l-ol (6aR,10aR)-6a,7,8,9,10, 10a-hexahydro-6,6-dimethyl-9-methylene-3-3pentyl - 6H-dibenzol ëb,d] pyran-l-ol
25		TMA	(=) 3,4,5-trimethoxy-a-amethylphen-ethylamine

Kripërat e substancave të listuara në këtë tabelë, sa herë që ekzistenca e këtyre kripërave është e mundur.

LISTA E SUBSTANCAVE NË TABELËN II

Nr.	Emërtimi ndërkombëtar	Emërtime të tjera	Emri kimik
1	Amfetamine	Amphetamine	(+/-) -∀-methylphenethylamine
2	Dexamfetamine	Dexamphetamine	(+)-∀-methylphenethylamine
3	Dronabinol	(-)-trans-)-9-tetrahydrocannabinol	(6aR.10aR)-6a,7,8,10a-tetrahydro- 6,6,9-trimethyl -3-pentyl-6H-dibenzo(b,d) pyran-l-ol
4	Fenetylline		7-[-2]∀-methylphenethyl)amino]ethyl] theophylline
5	Levamfetamine	levamphetamine	(-) - (R)- ∀-methylphenethylamine
6		Levometham-phetamine	(-)-,∀-dimethylphenethylamine
7	Mecloqualone		3-(o-chlorophenyl)-2-methyl-4 (3H)-quinazolinone
8	Metamfetamine	Methamphetamine	(+)-(S)-N-∀-dimethylphenethylamine
9	Metamfetamine Racemate	Methamphetamine Racemate	(+/-)-N, ∀-dimethylphenethyliamine
10	Methaqualone		2-methyl-3-o-tolyl-4(3H)-quinazolinone
11	Methylphenidate		Methyl ∀-phenyl-2-piperidineacetate
12	Phencyclidine	Pcp	1-(1-phenylcyclohexyl) piperidine
13	Phenmetrazine		3-methyl-2-phenylmorpholine
14	Secobarbital		5-allyl-5-(1-methylbutyl)barbituric acid

Kripërat e substancave të listuara në këtë tabelë sa herë që ekzistenca e këtyre kripërave është e mundur

LISTA E SUBSTANCAVE NË TABELËN III

Nr.	Emërtimi ndërkombëtar	Emërtime të tjera	Emri kimik
1	Amobarbital		5-ethyl-5-isopentylbarbitunc acid

2	Buprenorphine		2 (-cyclopropyl-7-∀-ë(S)-1-hycroxy-1,2,2-trimethylpropyl]-6,14 (endo-ethano -6,7,8,14-tetrahydro-oripavine
3	Butalbital		5-ailyl-5-isobutylbarbituric acid
4	Cathine	(+)-norpseudo-ephedrine	(-)-(R)- ∀ë(R)-aminoethyl)benzyl alcohol
5	Cyclobarbital		5-l-cyclohexen-l-yl)-5-ethylbarbituric acid
6	Glutethimide		2-ethyl-2-phenylglutarimide
7	Pentazocine		(6R, 6R,1 1R)-1,2,3,4,5,6-hexahydro-6 1 l-dimethyl-3-(3-methyl-2butenyl)-2, 6-methano-3-benzazocin-3-ol
8	Pentobarbital		5-ethyl-5-(1-methylbutyl) barbituric acid

Kripërat e substancave të listuara në këtë tabelë, sa herë që ekzistenca e këtyre kripërave është e mundur .

LISTA E SUBSTANCAVE NË TABELËN IV

Nr.	Emërtimi ndërkombëtar	Emërtime të tjera	Emri kimik
1	Allobarbital		5,5-diallylbarbituric acid
2	Alprazolam		8-chloro-l1 methyl-6-phenyl-H-S- triazolo [4,3,] [1,4], benzodiazepine
3	Amfepramone		2-(diethylamino) propiophenone
4	Barbital		5,5-diethylbarbituric acid
5	Benzfetamine	Benzphetamine	N-benzyl-N, ∀-dimethylphenethylamine
6	Bromazepam		7-bromo-1,3-d1hydro-5-(2-pyridyl)-2H-1, 4-benzodiazepin-2-one
7	Butobarbital		5-butyl-5-ethylbarbituric acid
8	Camazepam		7-chloro-1,3-dihydro-3-gydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one dimethylcarbamate (ester)
9	Chlordiazepoxide		7-chloro-2-(methylamino)-5-phenyl-3H-1,4-benzodiazepine-4-oxide
10	Clobazam		7-chloro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,5-benzodiazepine-2,4(3H,5H)-dione
11	Clorazepam		5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-7-nitro-2H-1, 4-benzodiazepin-2-one
12	Clorazepate		7-chloro-2,3-dihydro-2-oxo5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine- 3-carboxylic acid
13	Clotiazepam		5(-o-chlorophenyl-7-ethyl-1,3dihydro-1-methyl-2H-thieno (2,3-e) -1,4-diazepin-2-one
14	Cloxazolam		10-chloro-1 1b-(o-chlorophenyl),2,3,7 1 1b-tetrahydrooxazolo[(3,2-∀)], [(1,4],benzodiazepin-6 (5 H)-one
15	Delorazepam		7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1, 4-benzodiazepin-2-one
16	Diazepam		7-chloro-l,3-dihydro-l-methyl-5-phenyl-2H-l, 4-benzodiazepin-2-one
17	Estazolam		3-chloro-6-phenyl-4H-s-triazolo [4,3-∀] [1,4] benzodiazepine
18	Ethchlorvynol		l-chloro-3-ethyl-l-penten-4-yn-3-ol
19	Ethinamate		l-ethynylcysiohekanol carbamate
20	Ethyl Loflazepate		Ethyl 7-chloro-5-(o-fluorophenyl) 2,3-dihydro-2-oxo-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylate
21	Etilampfetamine	N-ethylamphetamine	N-ethyl-∀-methylphenethylamine
22	Fencamfamin		N-ethyl-3-phenyl-2-norbornanamine
23	Fenproporex		(+/--3[∀-methylphenethyl) amino] propionitrile
24	Fludiozepam		7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-

			2H-1,4-benzodiazepin-2-one
25	Flunitrazepam		5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-2H-1,4-benzodiasepin-2-one
26	Flurazepam		7-chloro-1-[2-(diethylamino)ethyl]-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
27	Halazepam		7-chloro-1,3,-dihydro-5-phenyl-1-(2,2,2-trifluoroethyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
28	Haloxazolam		10-bromo-11b-(o-fluorophenyl)-2,3,7,1 1b--tetrahydrooxazolo [3,2-∀] [1,4] benzodiazepin-6(5H)-one
29	Ketazolam		11-chloro-8, 12b-dihydro-2,8-dimethyl-12b-phenyl-4H-[(1,3)] oxazino [(3,2-a)] [(1,4)]benzodiasepine-4,7 (6H)-dione
30	Lefetamine	SPA	(-)-N,N-dimethyl-1,2-diphenyl-ethylamine
31	Loprazolam		6-(o-chlorophenyl)-2,4-dihydro-2-[(4-methyl-l-piperazinyl) methylene]-3-nitro-1H-limidozo [1,2-∀][1,4]benzodiazepin-l-one
32	Lorazepam		7-chloro-5-(o-chilophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
33	Lormetazepam		7-chloro-5-(o-chlorophneyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-2H-1,4-benziadezepin-2-one
34	Mazindol		5-(o-chlorophenyl)-2,5-dihydro-3H-imidazo [2,1-∀] isoindol-5-o1
35	Medazepam		7-chloro-2,3-dihydro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine
36	Mefenorex		N-(3-chloropropyl)-a-methyl-phenethylamine
37	Meprobamate		2-methyl-2-propyl-1,3-propanediol dicarbamate
38	Methyl-phenobarbital		5-ethyl-l-methyl-5-phenylbarbituric acid
39	Methyprylon		3,3-diethyl-5-methyl-2,4-piperidinedione
40	Midazolam		3-chloro-6-(o-fluorophenyl)-1-methyl-4H-imidazo(1,5-∀) (1,4) benzodiazepine
41	Nimetazepam		1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
42	Nitrazepam		1,3-dihydro-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
43	Nordazepam		7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
44	Oxazepam		7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
45	Oazolam		10-chloro-2,3,7,1,1b tetrahydro-2-methyl-1 1b-phenyloxazolo [3,2-d] [1,4] benzodiazepin-6(5H)-one
46	Pemoline		2-amino-5-phenyl-2-oxazolin-4-one 2-imino-5-phenyl-4-oxazolidinone
47	Phendimetrazine		(+)-(2S,3S)-3,4-dimethyl-2-phenylmorpholine
48	Phenobarbital		5-ethyl-5-phenylbarbituric acid
49	Phentermine		∀-∀-dimethylphenethylamine
50	Pinazepam		7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2-propynyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
51	Pipradrol		∀,∀-diphenyl-2-piperidinemethanol
52	Prazepam		7-chloro-1-(cyclopropylmethyl)-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
53	Pyrovalerone		4-methyl-2-(1-pyrrolldinyl) valerophenone
54	Secbutabarbital		5-sec-butyl-5-ethylbarbituric acid
55	Temazepam		7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one.
56	Tetrazepam		7-chloro-5-(1-cyclohexen-1-yl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
57	Triazolam		3-chloro-6 -(o-chiorophenyl)-1-methyl-4H-s-triazolo(4,3-∀) (1,4) benzodiazepine
58	Vinylbital		5-(1-methylbutyl)-5-vinylbarbituric acid

Kripërat e substancave të listuara në këtë tabelë, sa herë që ekzistenca e këtyre kripërave është

e mundur.